

# AKT - T H E M E L I M I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “Coffee Partner” sh.p.k

Me ane te ketij dokumenti, te emertuar Akt – Themelmi,ortaku:

- **Adrian Bardhi**, I biri i Nikolla, dtl.24.08.1970, lindur ne Durres, banues ne : Durres, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes kartes id Nr.H00824167H
- **Anesti Xharra**,I biri I Filipit.dtl.30.08.1980, lindur nr durres ,banues ne Durres, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes I kartes id.nr.I00830067E

Bihet dakort per sa me poshte vijon :

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar : **“Coffee Partner” sh.p.k**

Selia e shoqerise caktohet ne : **L.14 , rr. “ Asti Gogoli” prane shoqerise AD Pascucci Caffè Shkozet ,Durres.**

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje afat kohor te pakufizuar.

1.Objekti I veprimtarise se Shoqerise eshte :

Tregetine me shumice dhe me pakice ,te artikujve te ndryshem industrial e ushqimore,import export te kafes dhe produkteve te saj ,ekspresave,makinave tip distributor per kafe dhe produkteve te saj.

Prodhimin , importimin dhe eksportimin , shperndarjen me dhe/ose pa magazine , kombetare , si dhe ne komunitetin europian dhe jashte tij, edhe me marrjen e mandateve te perfaqesise me dhe/ose pa magazine , te artikujve ushqimore , te veshmbathjeve per burra , gra ,femije te cfaredo lloj perberje dhe vlere , perfshire bluze dhe kemishi te jashtme, aksesore per veshjet te cfaredo lloj materiali ( pervec atyre me objekte me vlere ) , kepuce , veshmbathje lekure, copa te cfaredo lloj materiali, fije dhe aksesore rrobaqepesie , paisje dhe artikuj sportive , rroba banjo , te brendeshme te cfaredo lloji dhe materiali , parfume , kosmetike , bizhuteri , artikuj per dhurata , kinkaleri , produkte kancelarie , produkte tekstile te cfaredo lloji dhe materiali perfshire ato te arredimit te shtepive dhe per kujdesin e higjenes e njeriut.-----Ky aktivitet mund te kryhet si ne menyre te drejteperdrejte ashtu edhe me perfaqesim komunitar , kombetar dhe te huaj.----- Shoqeria mundet gjithashtu te perfoje dhe marri shperndarjen me franchising, pra te kete te drejte te shperndaje markat e saj eventuale dhe dijen dhe eksperiencen e saj (know-how) ne franchising.----- te beje cfaredo lloj aktiviteti plotesues te pershtatshme dhe te lidhur me cka eshte permendur me lart brenda limiteve ligjore:----- te gjitha operacionet dhe veprimet tregetare , reklamuese , mobiliare, patundshmeri, industriale dhe ne menyre jo mbizoteruese dhe jo te drejtuar publikut,



te gjitha veprimet financiare dhe kredituese ( pervec cdo lloj forme lizingu aktiv , VENDET FINANCIARE aktive dhe NDERMJETESIMI MOBILIAR I rezervuar me ligj personave Juridik te ndryshem) te konsideruara te nevojshme ose dobijeshme per arritjen e qellimit social : mundet te bleje ose marre me qera dhe mund te marre persiper ne menyre direkte ose indirekte interesat dhe pjesmarrjet ne Shoqeri te tjera me objekt te te ngjashem ose te perafert me tonin, po gjithmone qe mos te rezultoje I modifikuar objekti social.-----

Jane absolutisht te perjashtuara nga objekti aktivitetet kredidhenese dhe te tjera qe per ligj i rezervohen Bankave ose ndermjetesve te tjere financjare dhe, ne cdo rast, cdo aktivitet qe ka si rezultat mbledhjen ose nxitjen e kursimeve te publikut.

**Kapitali fillestar I shoqerise eshte 100.000(njeqindmije) leke, I ndare ne 100 pjese, me vlere nominale 1.000 leke secila.**

Ky capital perbehet nga kontributet e meposhtme ne para te ortakeve :

- **Adrian Bardhi 50.000 leke, zoterues 50% te kapitalit**
- **Anesti Xharra 50.000 leke, zoterues 50% te kapitalit**

Shuma e nenshkruar do te depozitohet ne Banke ne afatin dhe kushtet qe percaktohen per kete qellim me vendim te zakonshem te shoqerise.

Administratoret emerohen me afat **5 vjet** me te drejte riperteritje.

**Administratore caktohet : Anesti Xharra**

Administratori gezon kompetencat dhe I ushtron ato ne perputhje me ligjin dhe statutin e shoqerise. Shoqeria ka nje Administratore . Me vendim te Ortakeve mund te shtohet numri I Administratoreve.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Durres ne tre ekzemplare origjinale duke pasur te gjithë ekzemplaret fuqi te barabarte ligjore.

Ortaket, pasi kane kuptuar te gjithë perbmajtjen e Statutit dhe Akt- Themelimit dhe pasojat ligjore qe pasojne, me vullnetin e lire dhe nen pergjegjesine personale I nenshkruan duke I dhene fuqi ligjore.

Durres,me 02.12.2013

**FIRMOSUR NGA ORTAKET : ANESTI XHARRA**

**ADRIAN BARDHI**

*Adrian Bardhi*

*Anesti Xharra*

*Xharra*

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Coffee Partner” sh.p.k**

Me kete Statut, Ortaket:

- **Adrian Bardhi**, I biri i Nikolla, dtl.24.08.1970, lindur ne Durres, banues ne : Durres, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes kartes id Nr.H00824167H
- **Anesti Xharra**,I biri I Filipit.dtl.30.08.1980, lindur nr durres ,banues ne Durres, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtes I kartes id.nr.I00830067E

Deklarojne te themeluojne shoqerine **“Coffee Partner” sh.p.k**

**KREU I**

**FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZJATJA**

Neni 1

**FORMA**

I. Shoqeria eshte person juridik I formes “SH.P.K”.

II. Shoqeria eshte person juridik e krijuar ne baze te ligjit shqiptar ne fuqi

III..Aktivitetin ajo do ta zhvilloje sipas ketij Statuti,legjislacionit shqiptar tregetar dhe atij nderkombetar si dhe legjislacionit ter pergjithshem te aplikueshem ne fuqi

Neni 2

**EMERTIMI**

Emertimi Tregetar I Shoqerise ne tregun vendas dhe te huaj dhe ne mardhenie me te trete eshte :

**“Coffee Partner sh.p.k**

Neni 3

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

1.Objekti I veprimtarise se Shoqerise eshte :

Tregetine me shumice dhe me pakice ,te artikujve te ndryshem industrial e ushqimore,import export te kafes dhe produkteve te saj ,ekspresave,makinave tip distributor per



kafe dhe produkteve te saj.

Prodhimin , importimin dhe eksportimin , shperndarjen me dhe/ose pa magazine , kombetare , si dhe ne komunitetin europian dhe jashte tij, edhe me marrjen e mandateve te perfaqesise me dhe/ose pa magazine , te artikujve ushqimore , te veshmbathjeve per burra , gra ,femije te cfaredo lloj perberje dhe vlere , perfshire bluze dhe kemisheri te jashtme, aksesore per veshjet te cfaredo lloj materiali ( pervec atyre me objekte me vlere ) , kepuce , veshmbathje lekure, copa te cfaredo lloj materiali, fije dhe aksesore rrobaqepesie , paisje dhe artikuj sportive , rroba banjo , te brendeshme te cfaredo lloji dhe materiali , parfume , kosmetike , bizhuteri , artikuj per dhurata , kinkaleri , produkte kancelarie , produkte tekstile te cfaredo lloji dhe materiali perfshire ato te arredimit te shtepive dhe per kujdesin e higjienen e njeriut.-----Ky aktivitet mund te kryhet si ne menyre te drejteperdrejte ashtu edhe me perfaqesim komunitar , kombetar dhe te huaj.----- Shoqeria mundet gjithashtu te perftoje dhe marri shperndarjen me franchising, pra te kete te drejte te shperndaje markat e saj eventuale dhe dijen dhe eksperiencen e saj (know-how) ne franchising.----- te beje cfaredo lloj aktiviteti plotesues te pershtatshme dhe te lidhur me cka eshte permendur me lart brenda limiteve ligjore:----- te gjitha operacionet dhe veprimet tregetare , reklamuese , mobiliare, patundshmeri, industriale dhe ne menyre jo mbizoteruese dhe jo te drejtuar publikut, te gjitha veprimet financiare dhe kredituese ( pervec cdo lloj forme lizingu aktiv , VENDET FINANCIARE aktive dhe NDERMJETESIMI MOBILIAR I rezervuar me ligj personave Juridik te ndryshem) te konsideruara te nevojshme ose dobijeshme per arritjen e qellimit social : mundet te bleje ose marre me qera dhe mund te marre persiper ne menyre direkte ose indirekte interesat dhe pjesmarrjet ne Shoqeri te tjera me objekt te te ngjashem ose te perafert me tonin, po gjithmone qe mos te rezultoje I modifikuar objekti social.-----

Jane absolutisht te perjashtuara nga objekti aktivitetet kredidhenese dhe te tjera qe per ligj i rezervohen Bankave ose ndermjetesve te tjere financjare dhe, ne cdo rast, cdo aktivitet qe ka si rezultat mbledhjen ose nzitjen e kursimeve te publikut.

Neni 4

SELIA

Selia e shoqerise caktohet ne : **L.14 , rr. “ Asti Gogoli” prane shoqerise AD Pascucci Caffè Shkozet ,Durrës.**

Neni 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise caktohet me afat te pa kufizuar.

KREU II

KAPITALI FILLESTAR, KONTRIBUTET, PERGJEGJESIA, LEVIZJET E KAPITALIT,



KUOTAT DHE KALIMI I TYRE.

Neni 6

KAPITALI

Kapitali fillestar eshte **100.000 (njqindmije) leke.**

Neni 7

PJESET E KAPITALIT

- I. Kapitali themeltar eshte I ndare ne 100 pjese me vlere nominale 1.000 leke secila.
- II. Kontributet respektive te ortakeve :

- **Adrian Bardhi 50.000 leke, zoterues 50% te kapitalit**
- **Anesti Xharra 50.000 leke, zoterues 50% te kapitalit**

Vlera e kontributit te ortakeve ne kapitalin e shoqerise do te depozitohet ne banke pas vendimit qe Asambleja e ortakeve do te marre per kete qellim dhe sipas procedurave qe do te caktohen ne kete vendim.

Kur pjeset e kapitalit perqendrohen tek nje person I vetem (fizik ose juridik), shoqeria tregetare vijon te funksionoj si shoqeri me ortak te vetem dhe dispozitat e statutit gjejne zbatim, per aq sa jane te pershtatme dhe per ortakun e vetem.

Neni 8

KONTRIBUTET

Kapitali themeltar dhe kontributet qe perbejne ate akordohen ne para (leke).

Neni 9

PERGJEGJESIA

- I. Shoqeria pergjigjet me aktivet e saj per detyrimet qe mund te vijne nga veprimtarite e ushtruara.
- II. Ortaket nuk pergjigjen personalisht per detyrimet e shoqerise. Ortaket mbulojne humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributit te nenshkruar.

Neni 10

LEVIZJET E KAPITALIT

- I. Ne vijim te veprimtarise kapitali I shoqerise mund te jete objekt ndyshimi – zmadhimi ose zvogelimi, me vendim te posacem te asamblese se ortakeve te shoqerise.



- II. Ndryshimi I kapitalit behet nga asambleja e pergjithshme, e cila, merr vendime me shumice te cilesuar.
- III. Zmadhimi I kapitalit nuk mund te behet, pa u shlyer plotesisht kontributet e nenshkruara me pare
- IV. Ndryshimi I kapitalit nuk cenon te drejtat qe rrjedhin nga kontributet me perparesi apo te drejtat qe derivojne nga kontributet ne forme financimi per shoqerine. Kontributet ne forme financimi qe mund ti jepen shoqerise nga ortaket nuk prodhojne interesa.
- V. Shoqeria mund te marre pjese dhe te investoj kapital ne ndermarje apo shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te perafert me te sajin dhe mund te kryej direkt apo indirekt te gjitha operationet tregatate, financiare me karakter te luajtshem e te paluajtshem. Shoqeria mund te hap dhe te mbaje llogari rjedhese ne leke apo valuta te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoj lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, komfort legjislacionit ne fuqi.

## Neni 11

### KUOTAT DHE KALIMI I TYRE

- I. Secili ortak gezon kuoten e tij ne shoqeri, te drejtat dhe detyrimet perkatese qe burojne nga zoterimi I kuotes, ne perpjestim me kontributin e dhene ne kapitalin e shoqerise.
- II. Kuotat dhe/ose pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Transferimi rregullohet sipas ketij statuti dhe vendimeve te asamblese se ortakeve per kete qellim.
- III. Ortaku qe deshiron te shese kuotat e tij jashte rrethit te ortakeve eshte I detyruar te njoftoj me shkrim ( leter rekomande) per kete qellim *shoqerine* dhe cdo *ortak individualisht*, duke bere te ditur kushtet e transferimit. Ne rast se, brenda 2 muajve nga data e marrjes efektivisht dijeni, ortaket nuk pergjigjen me shkrim per ushtimin e te drejtes se parablerjes, atehere miratimi I transferimit konsiderohet I dhene. Afati 2 mujor mund te shtyhet me vendim te zakonshem te asamblese, jo me shume se 10 dite, cdo here qe, njoftimi nuk permban detajimet e nevojshme per kushtet e transferimit. Ne rast se ortaket, brenda afatit 2 mujor, deklarojne se, do te ushtrojne te drejten e parablerjes, atehere, duhet te shlyejne brenda 30 diteve vleren e kuotave qe do te shiten. Afati 30 ditor fillon nga e vendimit per ushtimin e te drejtes se parablerjes. Nese ortaket nuk e shlyejne vleren e kuotave brenda afatit 30 ditor, e drejta e parablerjes shuhet.
- IV. Kalimi I kuotes dhe/ose pjeseve te kapitalit te te tretet jo ortak, nuk mund te behet ne kushte me te favorshme se ato qe I jane prezantuar ortakeve te shoqerise, ne te kundert ka vend per anulim te transferimit dhe sipas rastit shperblimin e demit.
- V. Kuota e shoqerise mund te zoterohet nga nje ortak I vetem ose ne bashkepronesi, ne menyre te barabarte ose jo. Ne rastin e kuotes qe zoterohet ne bashkepronesi, ne



- mardhenie me shoqerine dhe te drejten e votes, keta persona trajtohen si nje ortak I vetem dhe te drejta I ushtrojne nga nje perfaqesues I perbashket
- VI. Transferimi I kuotes ne bashkepronesi, I nenshtrohet fillimisht te drejtes se parablerjes se bashkepronareve te kuotes, e nese keta refuzojne, ortakeve te tjere, pastaj te treteve, sipas rregullimit te bere ne piken V me larte
- VII. Ndalimet e percaktuara ne statut dhe rregullimet perkatese zbatohen edhe ne rastin e pjestimit te kuotave.

### KREU III

## MARDHENIET E ORTAKEVE ME SHOQERINE, ASAMBLEJA E ORTAKEVE, VENDIMARRJA

### Neni 12

#### MARDHENIET NDERMJET SHOQERISE DHE ORTAKEVE

- I . Per interesat e shoqerise, me vendim te posacem, asambleja e ortakeve mund te vendosi riinvestimin, rritjen e ezervave ose rikapitalizimin I fitimeve te realizuara nga viti financiar
- II. Shoqeria ruan te drejten te pezulloje ose te anulloje kuoten e nje ortaku sa here qe egziston nje shkak I arsyeshem dhe I perligur
- III. Vendimi per pezullimin / anulimin eshte I vlefshem kur vendosin te gjithë ortakët qe perfaqesojne kuotat e shoqerise, pa llogaritur ketu perqindjen e orakut per te cilin diskutohet anulimi
- IV. Vendimi dhe kohezgjatja e pezullimit / anulimit duhet ti njoftohet ortakut perkates, I cili ka te drejten e ankimit ndaj vendimit te asamblese. Ankimi nuk pezullon vendimin e asamblese.
- V. Asambleja percakton me vendim nese ka vend per shperblimin e demit
- VI. Kuota e pezulluar / anuluar riprterrihet nga asambleja me te rene shkak, kur nje gje e tille pranohet nga shoqeria, ose me paraqitjen e vendimit te formes se prere te gjykates
- VII. Statuti sanksionon parimin qe, ne rrethana te njejta, ortakët gezojne te njejtat te drejta, kane te njejtat detyrime proporcionale te trajtohen ne menyre te barabarte. Ky parimsiguron mbrojtjen ne vazhdimesi te te gjithë te drejtave te ortakeve edhe atyre ne pakice kapitali. Eshte I pavlefshem cdo vendim qe ndryshon kete pike te nenit.
- VIII. Ortakët dhe Administratoret jane te detyruar te ruajne sekretin mbi Dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, si dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe



pjesore te tyre. Ata jane pergjegjes per pasojat e mundshme negative nga shkelja nga ana e tyre e sa me sipërthene. Detyrimi dhe pergjegjesia per sa eshte specifikuar ne kete nen, perfshinedhe Ekspertin Kontabel te Miratuar.

## Neni 13

### ASAMBLEA E ORTAKEVE

- I. Asambleja e pergjithsme eshte organi pergjegjes per marrjen e vendimeve per ceshtjet themelore, sic percaktohet ne nenin 81 te Ligjit tregetar
- II. Asambleja e pergjithsme mblidhet ne sesione te zakonshme te pakten nje here ne vi, e thirur nga administratori, kontabeli I miratuar, ortaket e shoqerise qe gezojne te pakten 5% te totalit te votave.
- III. Mbledhjet e asamblese organizohen ne seline e shoqerise, por kur egzistojne arsye objektive apo ne varesi te ceshtjes konkrete, mbledhjet mund te mbahen ne nje vend tjetër.
- IV. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e asamblese. Ne ushtimin e te drejtes per pjesmarrje, cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër, ose nje person I trete I zgjedhur prej tij.
- V. Asambleja thirret nepermjet njoftimit me shkrese (dorazi, rekomande) ose nepermjet postes elektronike e ortakut (adrese e sakte e postes elektronike, ne funksion te thirrjes, do te konsiderohet adrese e depozituar ne shoqeri nga ortaku). Njoftimi permban vendin, daten, oren dhe rendin e dites. Per rastet kur konfirmohet rregullisht se nje ortak ndodhet jashte shtetit te territorit te vendit ku zhvillohet mbledhja, atehere afati I njoftimit dyfishohet.
- VI. Vendimet e marra ne kundërshtim me percaktimin e rregullave te thirrjes jane te pavlefshme, vetem nese ortaket me unanimitet shprehen dakort pavarsisht per rregullat.
- VII. Ne shoqerine me nje ortak te vetem, funksionohet dhe atributet e asamblese ushtrohen nga ortaku I vetem
- VIII. Rastet e tjera qe kerkojne thirrjen e domosdoshme te asamblese se ortakeve do te konsiderohen ato te percaktuara ne nenin 82 te ligjit tregetar.





## Neni 14

### VENDIMARRJA

- I. Vendimet e asamblese se ortakeve merren me shumice te zakonshme, shumice te cilesuar, dhe ne raste te vecanta me kuorum unanim.
- II. Cdo ortak ka te drejte vote ne perpjestim me vleren niminale te kuotes se tij. Si rregull ortaket votojne ne menyre te hapur per ceshtjet rend dite, por ne rastet e vecanta me kerkesen e argumentuar te ortakut qe zoteron te pakten 10 % te votive, mund te aplikohet votimi I fshehte. Ushtrimi I te drejtes se votes per ortaket jot e pranishem ne asamble, behet shkrese e konfirmuar nga noteri, ose nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik : video koference , e- mail. Vota e derguar me e – mail eshte e vlefshme kur dergohet nga adresa zyrtare e depozituar nga ortakut ne shoqeri me kushtin brenda afatit te votimit per ate ceshtje rend dite per te cilen ortakut voton .
- III. Vendimet e zakonshme do te konsiderohen te vlefshme per shoqerine kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortaket qe zoterojne te pakten 2/3 e numrit total te votive, dhe, vendimi merret nga nje shumice prej te pakten 2/3 e pjesmarresve.
- IV. Vendimet e cilesuara do te konsiderohen te vlefshme per shoqerine kur ne mbledhjen e asamblese marrin pjese ortaket qe zoterojne te pakten 3/4 e numrit total te votive, dhe , vendimi merret nga nje shumice prej te pakten 3/4 e numrit total te votave
- V. Percaktimet e ketij neni korimin dhe vendimmarrjen nuk zbatohen per ato raste specifike kur ligji ose ky statut parashikojne ndryshe.
- VI. Nje ortak nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambeja shyrton ne rend dite dhe merr vendim per ndonje nga rastet e parashikuara ne nenin 89 te Ligjit tregetar. Ne keto raste, kuota e ortakut perkates nuk llogaritet ne perqindjen e kuorimit te nevojshem qe kerkohet nga statute.

### KREU IV

#### ADMINISTRIMI I SHOQERISE, KESHILLI I PUNEMARRESVE

### Neni 15

#### ADMINISTRATORI

- I. Administrator I shoqerise eshte personi fizik ortak ose jo ne shoqeri.



- II. Administratori emerohet me vendim te zakonshem statutor. Emerimi eshte I vlefshem ne rast se personi I zgjedhur me votim pranon emerimin e tij si administrator te shoqerise. Emerimi I administratorit behet me afat **5 vjet me te drejte ripërteritje**. Shkarkimi I administratorit behet me shumice te thjeshte ligjore (jo statutore) sipas nenit 86 / 1 dhe 95 / 6 te Ligjit tregetar/
- III. Administratori gezon kompetencat e parashikuara ne nenin 95 te ligjit tregetar dhe ato kompetenca te tjera te parashikuara ne nene te posacme te ketij ligji, apo qe lindin ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare.
- IV. Administratori mban detyrimet qe burojne nga ligjet ne fuqi, nga nenet 14-18, 95, 98 I Ligjit tregetar, por duke mos u kufizuar vetem ne keto nene te ligjit, nga statuti dhe vendimet e shoqerise si dhe nga parimet e mirebesimit, besnikerise, kujdesit dhe profesionalizimit. Administratori ndjek procedurat e njoftimit te akteve te shoqerise ne Institucionet Kompetente apo anasjelltas sipas rastit, perfaqeson shoqerine dhe leshon autorizime perfaqesimi per ceshte te natyrave specifike.
- V. Asambleja ka te drejte te marre ne shqyrtim veprimtarine e administratorit dhe/ose te procedoje per te ekzekutuar nje kerkim desmshperblimi ndaj tij. Vendimi perkates merret me shumice te zakonshme statutore.
- VI. Administratori detyrohet te demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara asaj nga veprimtaria e gabuar, parregullt, kundraligjshme, ne distancim te zgjeruar te politikave tregetare, etj.
- VII. Administratorit I takon rimbursimi I shpenzimeve te bera per arsye pune dhe/apo shperblime te vecanta, te cilat akordohen me vendim te zakonshem te shoqerise.
- VIII. Shoqeria mund te kete dy ose me shume administrator. Ne rast te administrimit me shume persona, shoqeria ne momentin e emerimit do te percaktoj me vendim tagrat e secilit dhe menyren e ushtrimit te funksioneve te administratorit. Administratori, ka te drejte qe, per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te shoqerise, te marre ne pune shtetas te ndryshem, duke lidhur kontrate sipas kritereve qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi te miratuar me Ligjin Nr. 7961 dt 12.07.1995 dhe me Ligjin Nr. 7703, dt 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore" si dhe ne pershtatje me rregullat e brendshme te disciplines dhe te punes te percaktuara nga vete punedhenesi.
- Administrator caktohet : Anesti Xharra**

Administratoret e shoqerise perfaqesojne me vete shoqerine per veprime juridike apo financiare te vlersueshme deri ne 1.000.000(nje milion) leke.Per veprime qe kalojne kete shume administratoret jane te detyruar te neshkruajne bashkarisht.



## Neni 16

### KESHILLI I PUNEMARRESVE

- I. Kur ligji parashikon detyimin e pranise se keshillit te punemarresve, keta te fundit kane te drejte te krijojne strukturat perkatese dhe rregulloret e brendshme te organizimit dhe funksionimit te tyre. Perfaqesuesi I keshillit te punemarresve nderton dhe shkemben informacion me perfaqesuesin ligjor te shoqerise per ceshtjet ne interes e tyre.

## KREU V

### LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

## Neni 17

### LARGIMI I ORTAKUT

- I. Cdo ortak, per shkaqe te arsyeshme, mund te largohet nga shoqeria tregetare.
- II. Largimi behet duke njoftuar me shrim 90 dite perpara shoqerine, ku te jene permendur edhe shkaqet e largimit.
- III. Administratori therret mbledhjen e asamblese, e cila merr ne shqyrtim njoftimin e ortakut.
- IV. Vendimi I asamblese se zakonshme (shumice ligjore) qe pranon largimin e ortakut, percakton ose jo vleren e kompesimit te ortakut qe largohet. Edhe kur shkaqet e largimit konsiderohen te arsyeshme apo anasjelltas, asambleja sipas rastit mund te caktojte nje demshperblim ne ngarkim te ortakut.

## Neni 18

### PERJASHTIMI I ORTAKUT

- I. Asamblea e zakonshme (shumice ligjore) mund te kerkoje perjashtimin nga shoqeria te ortakut, kur ekzistojne shkaqe qe vleresohen te arsyeshme prej saj per kete perjashtim. Ne percaktimin e kuorimit te mbledhjes se asamblese per kete qellim, nuk perfshihet pjesa e ortakut per te cilin diskutohet perjashtimi. Kerkesa I drejtohet gjykates e cila vendos nese arsyet e pretenduara legjitmojne ose jo perjashtimin e ortakut.



- II. Shoqeria dhe ortakut kane te drejte ti kunderdrejtojne njeri-tjetrit pretendime per demshperblim

Te gjitha te drejttat qe rrjedhin nga cilesia e ortakut shuhen ne daten e largimit ose vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjashtimin.

## KREU VI

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

#### Neni 19

##### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE

- I. Cdo vit financiar fillon ne 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor
- II. Llogarite vjetore, inventari, relacionet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe sipas rastit nga kontabli I miratuar, duhet te miratohen nga asamblea me vendim te zakonshem.
- III. Cdo ortak ka te drejte te vihet ne dijeni per pasqyrat financiare dhe llogarite e shoqerise ne cdo kohe, nepermjet nje kerkese te drejtuar administratorit 7 dite perpara.

#### Neni 20

##### DIVIDENTET

- I. Ortaket gezojne te drejten e terheqjes se fitimit te realizuar ne raport me kuotat e zoteruara.
- II. Pas miratimit te llogarive vjetore, Asamblea me vendim percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve apo/dhe shperndarjeve te mundshme. Asamblea, ne kete faze ose ne nje faze te mevonshme, por jo me larg se 3 muaj nga data e miratimit te llogarive vjetore, vlereson mundesine e aplikimit te parashikimeve qe vendos neni 12/1 I Statutit.
- III. Administratori siguron qe shperndarja e fitimit te kryhet ne respektim te kerkesave ligjore ne fuqi

## KREU VII

### BASHKIMI, NDARJA, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

#### Neni 21

##### BASHKIMI, NDARJA, PRISHJA

- I. Shoqeria, me vendim te cilesuar te asamblese se ortakeve, mund te vendosi bashkimin apo ndarjen e shoqerise.



- II. Modalitet per realizimin e ketij veprimi percaktohen sipas rastit, gjithashtu, ne perputhje me urdherimet ligjore ne fuqi.

Neni 22

#### LIKUIDIMI

- I. Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit ne momentin e prishjes se saj.
- II. Ne vendim, asamblea emerone nje ose disa likuidues, te cilet ndjekin hapat ligjore te likuidimit. Ne fund te procesit te likuidimit, asamblea, me shumice te zakonshme vendos miratimin e raportit te likuidimit, bilancit perfundimtar dhe gjithcka rreth procesit te likuidimit. Mbas pagimit te kreditorëve, likuiduesi dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar

#### KREU VIII

#### DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23

#### SHNDERRIMI I SHOQERISE

- I. Shnderimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose shoqeri komandite mund te kryhet vetem m e miratimin unanim te ortakeve, ndersa shnderimi ne shoqeri anonime, me miratimin e shumices se cilesuar te ortakeve te shoqerise

Neni 24

#### MOSMARRVESHJET

- I. Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, etj, fillimisht do te shqyrtohen me ndermjetesim sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi Ligji nr. 10385, dt 24.02.2011 "Per zgjidhjen e mosmarreshjeve me ndermjetesim", ne te kundert mund t'i paraqiten per zgjidhje gjykates ku ka seline shoqeria.

Neni 25

#### DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky Statut eshte hartuar ne 3 ekzemplare origjinale, duke patur te gjithë tekstet fuqi te barabarte Ligjore.

Durres, me 02.12.2013

**FIRMOSUR NGA ORTAKET : ANESTI XHARRA**

**ADRIAN BARDHI**

*Adrian Bardhi*

*Anesti Xharr*

*Xharr*